




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit (KL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Lipjanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Dobësi në vlerësimin e përzgjedhjes së kandidatëve.
- A2 Kriteret për ndarjen e bursave nuk ishin në pajtueshmëri të plotë me udhëzimin administrativ nr. 12/2018.
- A3 Mangësi në regjistrat e pasurive kapitale.
- B1 Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.
- B2 Mos pagesa e faturave brenda afatit prej 30 ditësh.
- B3 Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore / përbarimore.
- B4 Pranimi i shërbimeve para krijimit të urdhërbljes.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Lipjanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Lipjanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Lipjanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Lipjanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Lipjanit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësime, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit të cilat kanë të bëjnë me: klasifikimin e drejt të shpenzimeve, procedurat e rekrutimit të personelit, menaxhimi i subvencioneve, në menaxhimin e pasurive, dobësitë në menaxhimin e të arkëtueshmeve, obligimet e papaguara dhe detyrime kontingjente, përfshirë edhe kontrollet e brendshme të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Raporti i auditimit ka rezultuar me gjithsej 10 rekomandime, prej të cilave katër (4) janë rekomandime të reja dhe gjashtë (6) janë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Dobësi në vlerësimin e përzgjedhjes së kandidatëve

Gjetja Sipas nenit 10 të udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, lista definitive përpilohet duke u renditur pjesëmarrësit në testim dhe në intervistë sipas renditjes së pikëve të fituara nga testi dhe intervista ku sipas nenit 12 Komisioni i Përzgjedhjes nxjerr vendim për përzgjedhjen e aplikuesit i cili ka më së shumti pikë në listën definitive.

Ne kemi identifikuar se në konkursin për plotësimin e vendeve të punës për dy mjek të përgjithshëm, komisioni i vlerësimit nuk kishte bërë përzgjedhjen e kandidatëve sipas rezultateve të treguara në testin me shkrim dhe intervistës. Kandidati që plotësonte kriteret të ishte i pari në renditje sipas pikëve nga vlerësimi, i janë zbritur 10 pikë për përgjigje të sakta, ndërsa kandidati që ishte përzgjedhur i pari në renditje sipas pikëve, ishte vlerësuar me 10 pikë për përgjigje të pasaktë.

Komisioni i vlerësimit nuk kishte vlerësuar drejt kandidatet si pasojë e kujdesit jo të duhur.

Ndikimi Vlerësimi jo i drejt mund të ndikoj në përzgjedhjen e kandidatëve të pamerituar, si dhe të dëmton imazhin e institucionit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë marrjen masave të nevojshme në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, rritjen e kujdesit, në mënyrë që të bëhet përzgjedhja e kandidateve të merituar me më së shumti pikë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kriteret për ndarjen e bursave nuk ishin në pajtueshmëri të plotë me udhëzimin administrativ nr.12/2018

Gjetja Udhëzimi Administrativ nr. 12/2018 (MASHT), parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe Universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, neni 1 çertifikatat e notave nuk i nënshtrohen kësaj procedure dhe konform legjislacionit në fuqi, asnjë Institucion nuk mund të kërkojë njohjen e transkripteve të notave derisa studenti/ja është në ndjekje të studimeve.

Në konkursin e datës 30.09.2022 nr. 111/01-52779 për vitin akademik 2022/2023 për ndarjen e bursave, Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit me rregulloren e brendshme nr. 670/01-212160 për ndarjen e bursave neni 4 përcakton kriterin për nostrifikimin e dokumentacionit për studentët që studiojnë jashtë vendit. Ky kriter ishte në kundërshtim me UA.nr.12/2018, ngase certifikatat e notave nuk i nënshtrohen nostrifikimit. Ne kemi identifikuar se studentëve që studiojnë jashtë vendit nuk i'u janë ndarë bursa sepse nuk i kishin të nostrifikuara dokumentet (certifikatat e notave) nga MASHT, ngase e kanë të pamundur ta bëjnë një gjë të tillë, pasi rregullativa ia pamundëson.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos harmonizimit të kriterëve të përcaktuara në rregulloren e brendshme për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit me UA nr.12/2018.

Ndikimi Mos harmonizimi i kriterëve në rregulloren e brendshme me UA 12/2018 nga MASHT, ndikon që procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të mos zhvillohet si duhet, si dhe ka ndikuar që studentët të eliminohen nga përfitimi i bursave.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara për ndarjen e bursave të janë në pajtueshmëri me udhëzimin administrativ nga ministria përgjegjëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësi në regjistrat e pasurive kapitale

Gjetja Rregullorja nr. 02/2013 Për menaxhimin e pasurive jofinanciare, Neni 2 përcakton se: të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Pasuria e regjistruar në SIMK me numër të ID-së "2007000000002785" Ndërtimi i rrugëve të Lipjanit, ishte e regjistruar në vitin 2007, me vlerë bruto prej 102 milion, zhvlerësim të akumuluar prej 77 milion dhe vlerë neto në libra prej 25 milion në PVF-të e vitit 2022. Ne nuk kemi mundur të testojmë ekzistencën e tyre, për arsye të mos identifikimit të rrugëve dhe evidencave burimore në detaje. Sipas sqarimit të Komunës (me e-mail), lëndët në atë kohë janë regjistruar në thesar nga zyrtarja e pasurive, duke asistuar nga zyrtarët e thesarit, ngase Komuna nuk ka pasur qasje dhe mundësi në sistemin e SIMFK-së. Më tutje, për pasurinë në fjalë, komuna ka sqaruar se është regjistruar si vlerë komulative, ku janë përfshirë të gjitha asfaltimet në territorin e komunës së Lipjanit të cilat janë financuar me buxhetin e komunës dhe donatorëve prej viteve paraprake deri në vitin 2006.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrollit të brendshëm, me ç'rast ka mungesa të informacioneve relevante për regjistrimin e grupuar të asfaltimeve rrugore deri në vitin 2006.

Ndikimi Mungesa e dokumentacionit burimor të detajuar, shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë e detajuar që posedon komuna, si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrollit të brendshëm në mirëmbajtjen e regjistrave të pasurisë, për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë lehtë të qasshme, për tu identifikuar në regjistrat përkatës të pasurive komunale, si dhe për pasuritë e regjistruara si të grupuara të bëjë rivlerësimin e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të jo në pajtueshmëri me kërkesat ligjore

Gjetja Neni 6 i rregullores së MF - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, thotë se Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të përmban edhe informata për kohën e hapjes së thirrjes për aplikime dhe kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.

Plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ nuk ishte hartuar në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregullore, plani nuk përmbante informata për kohën e hapjes së thirrjeve për aplikime dhe kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.

Mos funksionimi i kontrollit të brendshëm në nivelin e duhur nga zyrtarët përgjegjës për hartimin e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, ishte shkak i mos hartimit të planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve.

Ndikimi Mos hartimi i planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregullore, ndikon në mos arritjen e objektivave për çfarë janë të parapara këto mjete dhe kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve/programeve përfituese.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për hartimin e planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ-të në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren 04/2017 për Mbështetje Financiare për kohën e hapjes së thirrjeve dhe kohën e përafërt të fillimit të zbatimit të projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos pagesa e faturave brenda afatit prej 30 ditësh

Gjetja Sipas nenit 39 të LMFPP, kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga testimi i mostrave dhe sipas listës së detyrimeve në fund vitë që ka komuna, kemi identifikuar se vonesat në pagesën e faturave e tejkalojnë kohën e paraparë me ligjin aktual. Vonesat sipas testeve tona janë nga tre në pesë muaj. Gjithsejtë vlera e faturave e prezantuara në PVF të cilat nuk janë paguar brenda 30 ditëve është 134,760€.

Shkaku i mos pagesave me kohë janë kontrollet e dobëta në menaxhimin e borxheve dhe menaxhimin e buxhetit.

Ndikimi Mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor rritë mundësinë që furnitorët të drejtohen përmbanuesve dhe gjykatave ku krijojnë shpenzime shtesë për buxhetin e komunës.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të

mjeteve si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik. Po ashtu, të forcojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore / përmbartimore

Gjetja Neni 39 i LMFPP, përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Përkundër zvogëlimit të shpenzimeve për procedurat përmbartimore krahas vitit të kaluar në vitin 2022 shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore ishte 354,842€, prej të cilave 58,986€, ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit, këto janë shpenzuar për paga jubilarë, mallra dhe shërbime, dhe investime kapitale.

Kjo ka ndodh si rezultat i mos pagesës me kohë të obligimeve financiare dhe kërkesave për paga jubilarë apo pagave përcjellëse, dhe pagesave ndaj furnitorëve, për të cilat nuk kishte pasur buxhet komuna për realizim të pagesave të tilla.

Ndikimi Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, po ashtu krijojnë kosto shtesë në emër të shpenzimeve gjyqësore dhe interesit.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë, që të ketë fondet e nevojshme për kategorinë e pagave, planifikim të mirëfillt si dhe të forcohen kontrollat në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Pranimi i faturave para krijimit të urdhërblërjes

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013- Shpenzimi i parave publike, neni 22- procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet kërkesa për blerje, lëshohet urdhër blerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjell faturën për pagesë.

Në 12 pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 346,911€ dhe në shtatë (7) pagesa të investimeve kapitale në vlerë prej 767,242€, kemi identifikuar se paraprakisht është pranuar fatura pastaj është krijuar urdhërblërja.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrollit të

brendshëm.

Ndikimi

Pranimi i faturave para krijimit të urdhër blerjes, mund të rezultojë me shërbime apo furnizime pa kërkesë nga njësia përkatëse, të cilat njëkohësisht mund të jenë jo të përshtatshme në kohë si dhe mund të ndikojnë në vonesa në pagesën e faturave.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte në vlerë prej 5,814,144€ prej të cilave ishin shpenzuar 3,967,128€ apo 68%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me realizimin e projekteve të ndryshme kapitale si ndërtimi i: objektit të administratës së komunës, asfaltimi i rrugëve të ndryshme, palestrave të ndryshme, shtretërve të lumenjve, çerdheve, kolektorëve, shtigjeve të ecjes etj.

Çështja B5 - Keqklasifikim i shpenzimeve kapitale

Gjetja Ligji Nr. 08/L-066 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe plani kontabël përcaktojnë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Gjithashtu UA Nr. 19/2009 për planin kontabël, neni 8.1 ka përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

Komuna ka blerë pajisje për çerdhe publike në Gadime dhe Sllovi në vlerë prej 48,969€ nga kategoria investime kapitale ndërsa do duhej të shpenzohej nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve pasi çmimi për njësi ishte nën 1000€.

Kjo gjendje është rezultat i planifikimit joadekuat të shpenzimeve në kodet ekonomike adekuate.

Ndikimi Keqklasifikimi ka mbivlerësuar kategorinë e investimeve kapitale dhe ka nënvlerësuar kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të arkëtueshmet

Vlera e shpalosur në PFV ishte 5,509,528€ me një rritje prej 241,709€ krahasuar me vitin 2021. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, shpronësimi dhe shfrytëzimi i pronës publike.

Çështja B6 - Menaxhim joefektiv i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas rregullores së Ministrisë së Financave nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, citon që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara. Po ashtu arkëtimi i të hyrave duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

- Sipas regjistrave vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2022 ishte 5,509,528€. Rritja në krahasim me vitin 2021 ishte 241,709€ ose 4.6%. Sfida kryesore mbetet arkëtimi i tatimit në pronë, i cili është rritur për 262,092€ ose 6% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021. Përkundër faktit se komuna ka marr masa lidhur me inkasimin e llogarive të arkëtueshme tek tatimi në pronë, duke dërguar vërejtje dhe njoftime përfundimtare tek tatimpaguesit rritja e tyre, edhe pse me intensitet më të ulët, vazhdon nga viti në vit. Kjo rritje vazhdon të ndikohet edhe nga borxhet e ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në vlerë prej 710,643€.
- Nga testimi i mostrave në vlerë prej 85,435€, kemi identifikuar mungesë të dokumentacionit si: aktvendimet për ngarkesën (faturat), kartelat analitike të klientëve që dëshmojnë të drejtën për arkëtim. Vlera e përgjithshme e llogarive të arkëtueshme për lejet afariste është 577,664€ të gjitha janë borxhe të vjetra dhe Komuna nuk aplikon më tarifa nga viti 2013. Zyrtarët përgjegjës nuk kanë më qasje në programin e vjetër për taksën në biznes ndërsa nuk janë bërë përpjekje për arkëtimin e tyre.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të kontroleve të brendshme, sistemit të vjetër për menaxhimin e taksës në biznes dhe ruajtjen e dokumentacionit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra dhe përpjekjeve të pamjaftueshme për arkëtimin e tyre.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me efekt negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake. Ndërsa mungesa e dokumentacionit për llogaritë e arkëtueshme për kategorinë e taksës në biznes pamundëson ofrimin e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme dhe marrjen e masave për arkëtimin e tyre.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afariste dhe ruajtjen e dokumentacionit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Detyrimet kontingjente

Vlera e shpalosur në PFV ishte 244,993€ me një zvogëlim prej 6,093€ krahasuar me vitin 2021. Kjo vlerë përbëhet nga padi të ndryshme ndaj komunës.

Çështja A4 - Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja Sipas Nenit 18 të Rregullores 01/2017 për Pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore: “Organizatave buxhetore në harmoni LMFPF-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente”.

Vlera prej 2,010€ e regjistruar si detyrim kontingjent, është dashur të regjistrohet si obligim i pa paguar në vlerë prej 2,246€, sepse Komuna ka një vendim përfundimtar të gjykatës i cili përveç detyrimit bazë përfshin edhe kamatën në vlerë prej 236€, dhe si i tillë është obligim financiar.

Shkak i regjistrimit të gabuar i detyrimeve kontingjente ishte mos përditësimi i regjistrit të kontingjencave me vendimin final të gjykatës përkatëse, kjo si rezultat i kujdesit jo të duhur.

Ndikimi Dobësitë e identifikuara në shpalosjet e detyrimeve kontingjente rezultojnë në mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për 2,010€ dhe nënvlerësim të obligimeve të papaguara për vlerën 2,246€.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës do të rrisin kujdesin në klasifikimin e drejtë të detyrimeve në Pasqyra Financiare Vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	17,593,652	19,351,934	16,777,728	17,808,414	17,751,726
Grante Qeveritare - Buxheti	15,484,829	15,499,703	14,313,829	15,027,299	15,498,441
Financimi përmes huamarrjes	0	176,635	176,635	69,971	144,330
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,000,914	685,145	665,239	634,753
Të hyrat vetanake	2,108,823	2,108,823	1,413,357	1,690,784	1,179,471
Donacionet vendore	0	7,519	6,762	34,001	973
Donacionet e jashtme	0	558,340	182,000	321,119	293,758

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,758,282€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak prej 1,000,914€, donacionet e jashtme dhe të brendshme 565,859€, financimi nga huamarrja 176,635€ dhe ndryshimet me vendim të Qeverisë me një rritje për 14,874€.

Në vitin 2022 Komuna ka shpenzuar 87% të buxhetit përfundimtar, me një zvogëlim të këtij proporcioni të shpenzimit prej 9% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	17,593,652	19,351,934	16,777,728	17,808,414	17,751,726
Pagat dhe mëditjet	9,886,000	10,082,770	9,483,910	10,075,472	9,574,292
Mallrat dhe shërbimet	1,998,000	2,164,577	2,080,588	1,742,262	2,538,030
Komunalitë	330,000	368,486	352,924	266,640	210,479
Subvencionet dhe transferet	766,000	921,957	893,179	445,909	592,738
Investimet Kapitale	4,011,911	5,814,144	3,967,128	5,278,131	4,836,186
Rezervat	601,741	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit:


Buxheti final për paga dhe mëditje është rritur nga buxhetit fillestar për 196,770€ apo 2% kjo ishte rezultat i huamarrjes prej 176,634€, vendimit të qeverisë nr. 32/116 për pagesat e shëndetësisë për muajin dhjetor/2022 për Covid 19 në vlerë 14,874€ dhe donacionit në vlerë prej 5,262€.

Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 166,617€ apo 8% nga Buxheti fillestar dhe kjo është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak prej 165,099€ dhe donacionit prej 1,518€. Gjithashtu buxheti final për komunalitë është rritur nga ai fillestar për 38,486€ apo 12% si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar.

Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 155,957€ apo 20% nga buxheti fillestar dhe kjo si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak.

Buxheti final për investime kapitale është rritur për 1,802,233€ apo 45% nga buxheti fillestar si rezultat i të hyrave të bartura në vlerë 641,412€, transferit të rezervës fillestare prej 601,741€ dhe granteve të përcaktuara të donatorëve prej 559,080€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Komuna ka planifikuar të realizoj 2,108,816€ të hyra të cilat janë pjesë e buxhetit fillestar dhe final. Realizimi ishte rreth 102% pra është tejkaluar planifikimi dhe ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga: tatimi në pronë, Lejet e ndërtimit, taksat rrugor, për regjistrimin e trashëgimisë, participime, taks për legalizim të objekteve etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	2,108,816	2,108,816	2,159,619	2,128,666	1,550,680
Të hyrat tatimore	1,201,705	1,201,705	1,237,277	1,078,479	761,366
Të hyrat jo tatimore	907,111	907,111	921,548	1,049,187	789,314
Të hyrat tjera	0	0	795	1,000	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 ka rezultuar me dymbëdhjetë (12) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Në Kuvendin Komunal ishte shqyrtuar raporti i ZKA-së, për PFV-të e vitit 2021. Deri në fund të auditimit për vitin 2022, Shtatë (7) rekomandime janë zbatuar dhe pesë (5) rekomandime janë të përsëritura, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e mbetura në fundvit të raportohen saktë në PFV, si dhe të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh.	Janë identifikuar raste edhe në këtë vit ku faturat nuk paguhen brenda afatit prej 30 ditësh.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë, që të ketë fondet e nevojshme për kategorinë e pagave, planifikim të mirëfilltë si dhe të forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që të shmangen shpenzimet shtesë.	Komuna edhe këtë vit ka vazhduar të ketë shpenzime të përbarimit.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë përmes personave përgjegjës që të ndjekin hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Nuk janë ndërmarr veprime pasi vazhdon situata e njejt edhe në vitin 2022	Nuk ka filluar zbatimin

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të duhura në mënyrë që vlerësimi i aplikacioneve të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrjet publike, duke mos tejkaluar vlerën e përcaktuar për ndarjen e subvencioneve.	Në vitin 2022 nuk janë identifikuar raste të tejkalimit të fondeve.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.	Nuk janë identifikuar raste në vitin 2022.	I zbatuar
6.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që përmes personave përgjegjës, që gjatë hartimit të PFV-e për vitin 2022, ti kushtohet vëmendje që mos të kenë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga ZKA dhe ZKF të nënshkruhen vetëm pasi që të janë siguruar që PFV janë të sakta dhe të plota.	Janë ndërmarr veprime dhe është rritur kujdesi në hartimin e PVF-ve të vitit 2022.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarr hapa në përmbushjen e kërkesave ligjore për vitet e ardhshme, të përgatitet Plani Vjetor për Mbështetjes Financiare 30 ditë pas miratimit të Buxhetit, Raporti Gjithëpërfshirës Vjetor i mbështetje financiare publike për OJQ, si dhe të dhënat që përfshihen në plan të korrespondojnë me Buxhetin e Miratuar.	Komuna akoma nuk ka plan vjetor të mbështetjes financiare të OJQ-ve.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara në thirrjet publike për mbështetje financiare të jenë të duhura në mënyrë që dokumentacioni i përcaktuar me kriteret siguron dëshmi të mjaftueshme për verifikimin e të dhënave të dorëzuara nga aplikuesit.	Janë ndërmarr veprimet e nevojshme.	I zbatuar
9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që kriteret e përcaktuara në konkurse të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme.	Janë ndërmarr veprime dhe në vitin e audituar nuk janë identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
10.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuata të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të saktë sipas kodeve ekonomike adekuata.	Është identifikuar edhe në vitin 2022 një rast i keqklasifikimit.	Nuk ka filluar zbatim

11.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se do të merr masat e nevojshme që planifikimi i aktiviteteve të prokurimit do të përfshijë kërkesat nga të gjitha njësitë në mënyrë që sa më pak aktivitete të realizohen jashtë planit të prokurimit. Nëse ndodh ndonjë aktivitet jashtë planit, paraprakisht duhet të njoftohet AQP konform kërkesave ligjore.	Janë ndërmarr veprime në njoftimin e AQP-së për rastet jashtë planit të prokurimit.	I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke intensifikuar bashkëpunimin me AKP-n lidhur me obligimet për NSH-të të cilat janë në menaxhimin e tyre, e po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve të vjetra nga lejet afariste.	Komuna akoma nuk ka arrit të ulë vlerën e Llogarive të Arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shehrije Shala, Drejtore e Auditimit



Muhamet Balaj, Udhëheqës i ekipit



Bahri Statovci, Anëtar i ekipit



Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

PRANUAR ME
Pranuar me: 09.06.23
Pranohet se:
Njezica / Broja: 1-470/03-29876
Numri / Broj:



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Lipjanit, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem** me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

IMRI AHMETI

Kryetar i Komunës së Lipjanit,

Data: 09.06.2023



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.